



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TË DREJTËS PËR INFORMIM  
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2383 Prot.

Tiranë, më 08/11/2024

### REKOMANDIM

**Nr. 25, datë 08/11/2024**

### PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS TË AUTORITETIT PUBLIK AGJENCIA E INOVACIONIT DHE EKSELENCËS

Në mbështetje të neneve 4, 6, 7, si dhe shkronja f) e nenit 9/1 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar,

### KONSTATOVA SE:

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 1.11.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës” i ndryshuar, rezulton se është krijuar Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, e cila ka për mision të kontribuojë, të nxisë dhe të promovojë inovacionin dhe angazhimin në administratën publike të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, ekselentë në implementimin e teknologjive të përparuara, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave në bashkëpunim me ministritë e linjës në fushat dhe sektorët përkatës lidhur me inovacionin.

Në pikën 1 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar përcaktohet se: “Autoritet publik” a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike”; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike”.

Për sa më sipër Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës konsiderohet autoritet publik, në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar.

Autoritetet publike, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë, si dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Pikat 2 dhe 3 të nenit 4 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, përcaktojnë se:

*“2. Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:*

*a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*

*b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*

*c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.*

**3. Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”.**

Programi i Transparencës vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës autoriteti publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet pasurimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të tij.

Në nenin 6 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, parashikohet se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.*

Në zbatim të shkronjës c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.

Urdhri nr. 187, datë 18.12.2020 është një akt nënligjor, i cili është publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 224 datë 22.12.2020<sup>1</sup>.

Gjithashtu, referuar shkronjës f) të nenit 9/1 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

---

<sup>1</sup> <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/12/18/187/eac66214-1453-4b4f-878e-50d3118f702d;q=urdher%20187%20date%2018.12.2020>

Personale: “f) bën rekomandime për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës”.

Për sa më sipër, autoriteti publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën për Informim me Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Konkretisht, bazuar në urdhrin e sipërcituar, të gjitha autoritetet publike përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre zyrtare të internetit rubrikat/kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Hyrje;
- Rreth Autoritetit: një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- Kuadri ligjor rregullator: tekstet e plota;
- E drejta për tu informuar dhe për tu ankuar: informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ushtrimit të mjeteve ligjore administrative;
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi autoritetin publik;
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të autoritetit publik;
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik/privat;
- Shërbimet që ofrohen nga autoriteti publik;
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë vendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve;
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
- Ndihma shoqërore/subvencionet të dhëna nga autoriteti publik;
- Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga autoriteti publik.

Informacioni duhet të publikohet i përditësuar, në çdo rast që pëson ndryshime, duke shënuar edhe datën e përditësimit të fundit. Autoriteti publik rekomandohet të përfshijë në programin e transparencës gjithashtu vendime të rëndësishme të tij, udhëzime të përgjithshme të detyrueshme, si dhe çdo informacion që çmohet i dobishëm për qytetarët.

Për lehtësinë tuaj, Programin Model të Transparencës, po jua bashkëlidhim këtë rekomandimi me CD. Gjithashtu bëjmë me dije se Zyra e Komisionerit ka hartuar udhëzime/rekomandime lidhur me vënien në zbatim të programit institucional të transparencës dhe mbetet në dispozicion të autoriteteve publike, mbi nevojat e tyre për paqartësi/informacion/ritje kapacitetesh, lidhur me zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoritetet publike kanë detyrimin ligjor të caktojnë një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Pika 1 e nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, përcakton se: “1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit”.

Koordinatori për të drejtën e informimit ka detyrimin e ushtrimit të kompetencave të parashikuara në pikën 2 të nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ku ndër të tjera është përgjegjës për bashkërendimin e punës për trajtimin e kërkesave për informacion të qytetarëve, si dhe për mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Në pikën 1 të nenit 8 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”.

Pika 2 e nenit 8 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, parashikon se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”.

Në zbatim të përcaktimit ligjor më sipër, Komisioneri ka miratuar formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve me Urdhërin nr. 188/2020 “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës dhe Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqësojnë instrumentet kryesore të promovimit të transparencës së autoriteteve publike dhe garantimit

të së drejtës për informim të publikut dhe çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht ti vërë në zbatim.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 6, 7, 8, shkronjës f) të nenit 9/1, si dhe shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar,

### **REKOMANDOJ :**

1. Autoriteti Publik Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, të vërë në zbatim, publikojë, pasqyrojë, përditësojë, ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publike, në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” të ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe këtij Rekomandimi brenda një afati 90 ditë nga momenti i marrjes dijeni të tij.
2. Titullari i Autoritetit Publik Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës të caktojë një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit dhe menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, t’i njoftojë Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit, në përputhje me pikën 1 të nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Koordinatori për të drejtën për informim pranë Autoritetit Publik Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, të krijojë, mbajë, bëjë publik dhe përditësojë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës b) të pikës 2, të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 8 ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar dhe sipas Urdhërit nr. 188/2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”.
4. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas neneve 18 dhe 19 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 08.11.2024 dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit.

### **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**